

## Zgjedhësit me Aftësi të Kufizuara



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i vendosur për të respektuar të drejtën e votës të çdo zgjedhësi, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Në përputhje me Udhëzimet përkatëse, Qendrat e Votimit në të gjithë vendin **do të jenë** të vendosura në katin e parë dhe duhet të kenë ndriçim të mjaftueshëm. Një pyetësor në lidhje me standartet e përshtatshmërisë u është shpërndarë paraprakisht Komisioneve të Zonës së Administrimit Zgjedhor **dhe autoriteteve lokale** në mënyrë që të merren të gjitha masat në kohë. Në ato ndërtesa në të cilat nuk ka rampë, KQZ<sup>1</sup> ka vendosur të mbulojë kostot e një rampe të përhershme në mënyrë që t'i shërbejë ndërtesës edhe në funksionet e tjera të saj, si p.sh shkollë, përveç si QV<sup>2</sup>. Një dhomë e fshehtë e përshtatur në lartësi do të gjendet në çdo QV. Fletë votimi për personat e verbër janë parashikuar në këto zgjedhje për të mundësuar votimin e tyre në pavarësi të plotë. Materialet edukuese për zgjedhësit do të ofrohen në formate të përshtatura si p.sh në gjuhën e shenjave, audio etj. në mënyrë që të respektohet e drejta e të gjithë zgjedhësve për informacion.

**Kujdes! Zgjedhësve me aftësi të kufizuar u jepet përparësi në rradhë pranë Qendrës së Votimit.**

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

<sup>2</sup> Qendër Votimi

## Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë

Përveç masave të ndërmarra më lart në mënyrë që zgjedhësit me aftësi të kufizuara ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në pavarësi të plotë, neni 108, KZ parashikon edhe ndihmën e një personi tjetër për ata zgjedhës të cilët për shkak të kufizimeve fizike nuk mund ta plotësojnë vetë fletën e votimit.

**Zgjedhësi**, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, **mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër**, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit.

Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës me aftësi të kufizuara, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit të QV-së se:

- do të votojë sipas udhëzimeve të zgjedhësit që po ndihmoj dhe nuk do të ndikoj në vendimin e tij/saj;



- se nuk kam votuar dhe nuk do të votoj për llogari të një zgjedhësi tjetër me aftësi të kufizuara;
- nuk do të bëjë publike votën e tij/saj.

Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në QV, kur kryhet kjo procedurë e votimit.

Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë

**Kujdes! Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës, që nuk mund të votojë vetë.**

**Kujdes! Anëtarët e KQV-së dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës, që nuk mund të votojë vetë.**

Autoritetet lokale që kanë në listat e tyre persona me aftësi të kufizuar kanë detyrim për të marrë masat në mënyrë që Qendrat e Votimit të përmbushin standartet e përshtatshmërisë siç parashikon ligji.

Gjithashtu, autoritetet lokale i dërgojnë KQZ-së numrin e zgjedhësve të verbër në mënyrë që të merren masat për të dërguar fletët e posaçme të votimit për ata, në Qendrat e votimit.

**Kujdes!** Zgjedhësit me aftësi të kufizuar **kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, të regjistrohen brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, jo më vonë se 40 (dyzet ) ditë para datës së zgjedhjeve.**

**Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë.**

Ky regjistrim bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve, si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

### **Kriteret për të qenë zgjedhës**

Në bazë të Nenit 44, KZ<sup>3</sup> për të votuar në Zgjedhjet e Përgjithshme të 23 qershorit 2013 një zgjedhës duhet:

- të ketë shtetësi shqiptare;
- të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;
- të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit;
- *të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone qendrore votimi.*

---


<sup>3</sup> Kodi Zgjedhor

Me t'u paraqitur në Qendrën e Votimit, zgjedhësi me aftësi të kufizuar kalon të njëjtat etapa si gjithë zgjedhësit e tjerë.

Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit:

- zgjedhësi thotë emrin e **tij/saj** dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit si më poshtë:

- o kartë identiteti  ; ose

- o pasaportë, për jashtë shteti  ;

### Procesi i Votimit

- kryetari kontrollon emrin në listën e zgjedhësve;



ndërkohë




- një anëtar **kontrollon zgjedhësit në të dy duart**, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme.

**Kujdes!** Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari përgjegjës i KQV-së ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në LPM të KQV-së dhe atij nuk i jepet fletë votimi.



- Kryetari, pasi **verifikon se të** dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve, atëherë **shënon** në listën e **zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit** të identitetit dhe **i heq vizë emrit të zgjedhësit** në këtë listë;

- zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij, përbri numrit të dokumentit të identifikimit;



- një anëtar tjetër, i caktuar me vendim të KQV-së, timbros zgjedhësin në gishtin e madh të dorës së majtë me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për minimumi 24 orë.



**Kujdes! Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.**

**Në rast se një votues nuk e ka gishtin e majtë të dorës së majtë, ai timbroset në gishtin e madh të dorës së djathtë.**

- Para se zgjedhësit t'i jepet fleta e votimit, ajo vulozet në pjesën e pasme të saj nga:

- Sekretari me vulën e KQV-së
- Kryetari me vulën e kryetarit të KQV-së.



- Kryetari i jep zgjedhësit fletën e votimit.

- Zgjedhësi merr :

- një fletë votimi:

### Fleta e Votimit



### Fleta e votimit Qarku Fier

Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, **palos** fletën e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të

fletës të jetë e dukshme.



Për më shumë informacion dhe formate të përshtatura të kësaj broshure ju lutem vizitoni: [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)